

URDHËR
Nr. 17, datë 9.2.2024

PËR DELEGIM TË KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të ligjit nr. 9000/2023, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Financave, Sekretarit të Përgjithshëm znj. Risenaxhaja, si vijon, për:

a) ndjekjen e komunikimit institucional me autoritetet kontraktuese dhe institucionet e tjera, për përmbushjen e detyrimit ligjor për depozitimin e tarifës koncesionare dhe pagesave të tjera me natyrë financiare, si dhe dërgimin e pasqyrave financiare vjetore të audituara dhe të konfirmuara nga autoritetet tatimore të vitit paraardhës të shoqërive koncesionare, sipas afateve të ligjit nr. 125/2023, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar;

b) mbikëqyrjen e raporteve periodike mujore të kontratave të koncesionit/PPP me mbështetje buxhetore, sipas formatit të shtojcës 8/1, me Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit;

c) ndjekjen dhe mbikëqyrjen e përmbushjes së rekomandimeve të raporteve të Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi zbatimin e kontratave koncesionare/PPP, të cilat janë pjesë e fushës së përgjegjësisë së Ministrisë së Financave;

d) trajtimin e çështjeve, praktikave dhe ndjekjen e komunikimit institucional për dhënie informacioni që lidhen me zbatimin e kontratave koncesionare/PPP apo legjislacionit në fuqi për koncesionet/PPP, si dhe vënien në dispozicion të dokumentacionit arkivor, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ndaj autoriteteve kontraktuese apo institucioneve të tjera shtetërore, shoqërive koncesionare, prokurorive dhe gjykatave;

e) ndjekjen dhe koordinimin e punës për ngritjen e bazës së të dhënave elektronike për Drejtorinë e Koncesioneve, për administrimin e dokumentacionit të prodhuar nga zbatimi dhe monitorimi i kontratave koncesionare/PPP.

2. Urdhri nr. 294, datë 29.12.2023, i ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për delegimin e kompetencave”, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, znj. Risenaxhaja, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
Ervin Mete